



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:136561

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830949

2024:136561

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Ismail Kuçi, në lëndën penale ndaj të pandehurit M.A nga fsh....-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.523/24 të dt.17 maj 2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 12 Qershor 2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Egzon Jakupi dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av. Sh. C, me dt.18 Qershor 2024 mori dhe shpalli, dhe të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.A nga fshati ..., Komuna Kaçanik, i lindur më dt.... nga i ati B... dhe e ëma Gjyle, e gjinisë L..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind I pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:....

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 02.04.2024, rreth orës 21:50 min. në fshatin ..., Komuna Kaçanik, i pandehuri në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr. 05/L-022, pa

autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armë, në atë mënyrë që ditën kritike derisa zyrtarët policor ishin duke e intervistuar të pandehurin për rastin e dhunës në familje, i njëjti kishte deklaruar se posedon një armë-pistoletë, me gas dhe me një karikator pa municion, me numër serik EU-..., ngjyrë e zezë, të njëjtën i'a dorëzon vullnetarisht zyrtarëve policorë.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,44,69,70 dhe 71 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-së, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 600.00 € (gjashtëqind euro), të cilin është i obliguar që t'a paguajë brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në 4 këste mujore.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zëvendesojë dënimin me gjobë, me dënim me burgim, duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit në shume prej 20.00€, të gjitha keto paguhen pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Konfor nenit 366 par.3 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet arma e tipi pistoletë me gaz me numër serik EU-... dhe një karikator pa municion.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.523/24 të dt.17 Maj 2024, të pandehurin M.A nga fsh....-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 par.3 të KPRK-së, dhe veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 12 Qershor 2024.

Prokurori I shtetit Egzon Jakupi në fjalën e tij, me rastin e prezentimit të aktakuës, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I pandehuri në fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke u arsyetuar se arma ka qenë jo funksionale, megjithatë e ndien veten të penduar për veprimin e tij, dhe i premtonte gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur, ndërsa i njejtë në fjalën e tij nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 par.3 të KPRK-së.

Prokurori I shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, për veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, andaj edhe i propozon gjykatës që të pranohet pranimi i fajësisë për të pandehurin, për veprën penale në fjalë, dhe t'i shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke e patur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Sh. C në fjalën e tij, në seancën e shqyrtimit fillestar, deklaroi se i mbrojturi i tij, e ka pranuar fajësinë për veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të njejtin t'a aprovojë, ndërsa me rastin e caktimit të dënimit i propozon gjykatës që të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese mungesën e rrezikshmërisë, pasi që arma ka qenë jofunksionale, faktin që i njejtë është i pagjykuar më parë, dhe posaqërisht pranimi i fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa konsideron se nuk ka rrethana rënduese në rastin konkret, meqë i mbrojturi i tij

vullnetarisht I ka dorëzuar armën policisë. Sa I përket sanksionit penal, I propozon gjykatës që te merren parasysh kushtet e dobëta ekonomike të të mbrojturit të tij, dhe mbi këtë bazë t'I shqiptohet një denim me gjobë I kushtëzuar. Fjalën e mbrojtësit e ka mbështetur në tërësi edhe I pandehuri.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, për veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vertetoi gjendjen faktike si në pikën II të dispozitivit të aktakuzës.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i cili nuk u kundërshtua edhe nga Prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit, dhe u aprovua edhe nga gjykata, konfor nenit 35 të KPP-së, me aktvendim të posaqëm bëhet veçimi i procedurës penale për veprën penale, Dhuna në familje nga neni 248 par.3 të KPRK-së.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur pendesë dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, bazuar në evidencën e gjykatës i njëjti nuk është recidivist i veprave penale, dhe faktin se i njëjti vullnetarisht u'a kishte dorëzuar armën zyrtarëve policorë, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale,

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.A, i akuzuar për veprën penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me

veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e armës të përshkruar si në dispozitiv, u mor në bazë të nenit 366 par.3 të KPRK-së lidhur me nenin 276 par.1 dhe 2 nënpar. 2.1 të KPPK-së

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2024:136561 datë 18.06.2024

Bashkëpunëtori Profesional
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.